

Lek Perwizi


**NE RRATHET
E FERRIT**

Album nga kampet e vdekjes

Kopërtina
Autoportret
Pluk, 1962.
Vaj mbi karton të presuar
28 x 32 cm

Lek Pervizi

*Në rrathët
e Ferrit*



Autportret

Kushtue gjithë viktimave të pafajshme
që diktatura komuniste ndryni në kampin
famëkeq të Tepelenës e ku shumë prej tyre
humbën jetën mes vujëve e mundimëve.

Gjyshës sime të mirë e dashun që
aty mbylli ditët e saj në moshën 90 vjeç
dhe i humbi varri bashkë me shumë të tjerë.

Mbi albumin e Lekë Pervizit

"Në rrathët e ferrit"

Nga Agron Tufa

Albumi që ju ofrojmë me këtë botim të Institutit të studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit (ISKK), na paraqet realitete të një Shqipërie fare pak të njohur, ndoshta vetëm nga ajo pjesë që mbeti apo një tepricë e vogël, që i mbijetoi skëterrës komuniste. Një pjesë përfaqësuese e këtyre pikturave që kemi mbledhur në këtë Album, i kanë mbijetuar ferrit komunist, fatmirësisht, bashkë me autorin e tyre, "piktorin e kampeve", siç është bërë zakon ta quajnë, zotni Lekë Pervizin, piktor, shkrimtar, poet, publicist, historian e përkthyes, një arkivë e gjallë memoriale me energji të pashtershme, ndonëse udhëton drejt të 86-ve në moshën e tij. Lekë Pervizi është ndoshta mishërimi më i saktë i atij karakteri të papërkulshëm që kishte parasysh Atë Zef Pllumi për atë, që ndjen brenda vetes imperativin "Rrno, për me tregue".

Autori i këtyre pikturave, portreteve, grafikave e vizatimeve është gjallë, por jo të gjithë, e ndoshta pjesa dërrmuese e personazheve të lapsit e thënjgjillit të tij, nuk është më. Ata na vijnë si jehonë e një të shkuare tragjike e çnjerëzore falë mjeteve rrethanore që i fiksoi lapsi e thënjgjilli i bashkëvuajtësit të tyre, Lekë Pervizit.

Ata portrete, etyde dhe skena të populluara me dijetarët e fisnikët e Shqipërisë mbetën prore në fletët e zverdhura të piktorit të ri, që ndau të njëjtin kalvar vuajtjesh e kuraje me ta, për t'u madhuar shpirtërisht e për të mos u përkulur para terrorit të policëve të kampeve, apo punës së rëndë dërrmuese dhe urisë shfytyruese. Secili portret në këto krijime të piktorit bart diçka nga hijet e hadesit komunist dhe duket sikur rreh të çajë mjegullimën e kohës barbare, peng i së cilës mbetën. Dhe duke i njohur, ne na sëmbon një brengë shumë më e mprehtë, se ajo që shpreh në vargjet e tij lapidare poeti ynë i vjetër, Pjetër Budi:

*"Ku janë ata pleq bujarë,
që qenë përpara ne,
e ata trima sqimatarë,
të shpejtë si rrufe?"*

Kështu parakalojnë duke çarë mjegullimën e kohës përmes grafitit e thënjgjillit personalitetet e shkencës, artit, mendimit dhe fisnikërisë shqiptare - profesor Ali Cungu, shkrimtari Mitat Arianiti, doktor Nedim Kokona, oficer Valentin Pervizi, Ibrahim Sokoli, filologu e përkthyesi prof. Guljem Deda, Pjetër Bardheci, Dr. Sandër Sara, Loro Muzhani, Dr. Ali Erebara, Latif Spahiu e Eshref Frashëri, Ded Gjoarkaj, studentët - Viktor Dosti, Ylber Starova, Thabit Rusi, Tomorr Dine, Reshit Mulleti, Ernest Dosti, deri tek malësorët Llesh Dodë Gjini, Gjin Lleshi, Bajazit Kaloshi, mbesat e autorit Eva dhe Edi, nëna, dhe portretet e grues Beba, deri tek djemtë e piktorit, Leonard, Dorian e Aurel Pervizi. Pikturat, vizatimet, skenat dhe etydet e Lekë Pervizit nuk u krijuan në kushte normale, për t'i paraqitur para syrit vlerësues të jurive në ndonjë përvjetor të partisë apo jubile çlirimi. Ata fiksuan atë përditshmëri të kampeve të vdekjes, për të dëshmuar ekzistencën me tmerret e privimet e saj nën egërsinë e kërbaçit dhe mizorive të policëve, siç na paraqiten në skenat e vizatuara brenda kampit dhe në punë të detyruar. Këto skena, grafika, kompozime janë lënda e errët e një përditshmërie të përzishme,

që brezave të sotëm nuk arrin t'ua rrokë truri. Virtyti artistik është i mpleksur në këto krijime me ankthin e mbijetesës në atë mënyrë, sa bëhet i pamundur (dhe i panevojshëm) kufiri midis etikes dhe estetikës.

Në zhairimën mortore që kanoset të pllakosë çdo natë kampet e Kuçit, Turanit, Tepelenës apo Porto Palermos, nuk ka kohë për ajëtime estetike a stërhollime manierish, sepse në beft rri vdekja, në çdo çast: vdesin fëmijët nga uria dhe epidemitë, vdesin pleqtë e të rinjtë nga puna e rëndë dhe, në mbijetesën e çdo dite, mblidhet mbrëmjeve ky fis i naltë njerëzor për të biseduar për shkencën e artin, diskutohen vargjet e përkthyer nga poetë latinë e italianë, për të qëndruar me dinjitet përballë shuarjes së ngadaltë në këto kampe vdekjeje, ku kishin grumbulluar familjet më patriotike të Veriut të Shqipërisë.

Andaj dhe piktori i këtyre kampeve, Lekë Pervizi, i biri i një akademisti ushtarak, zâmadh në historinë e Shqipërisë mbretnore, gjeneral Prenk Pervizi, e ndjente peshën e këtyre grimçasteve të ikshme ku jeta e njeriut tretet fir, duke lënë një kujtim të vagullt, që zor t'i mbijetojë kujtesës. Dhe përmbushja e detyrës së kujtesës është një mision i lartë njerëzor, në çfarëdo realiteti të imponuar të ndodhesh. Duke i fiksuar me ç'të mundë e si të mundë, Lekë Pervizi na e përvijon me dramacitetin e artit këtë detyrë njerëzore, pa i bërë apelin penelit të tij, në do t'i pëlqejë kujt apo jo. Dhe ky grimçast i fiskuar me përshkënditjen krijuese është shkarkuar me shpejtësinë e blicit të rrufesë dhe bart duhmën e shkrumbit të rrufesë, tashmë jo sipas imperativit të famshëm të Horacit latin - "kape çastin", por si në postulatit poetik e dramatik të poetit nobelist rus, Josif Brodskijt (gjithashtu një ish i internuar në BRSS):

"Ndalo grimçast! Ti s'je aq i bukur, sa ç'je i papërsëritshëm".

Tani, në kushtet kur ne, me plotë të drejtë, duhet t'u drejtohem këtyre vendeve të vuajtjeve e dhimbjeve, "Aushvicëve shqiptarë", si Vloçishtit, Beratit, Tepelenës e Porto Palermos, për turpin tonë të parrëfyeshëm nuk gjejmë më gur mbi gur! As burgjet drithëruese, as kampet e shfarosjes. Duket sikur kujtimet e atyreve, që i rrëfejnë këto mizori, kanë ndodhur dikur heret, në një pakujtesë që i përket, fjala vjen, periudhës para Krishtit. Sepse në këtë topografi me dhimba e sfilitje njerëzore nuk ka mbetur një tullë, a një dërrasë. Ajme! Nuk ndodhi si me vendet e tjera ish komuniste. Burgjet dhe kampet e shfarosjes nuk u kthyen në apele njerëzore të kujtesës. Në këtë vend ku u derdh gjithë egërsia e pashoqe e komunizmit, nuk u kujdes kush, jo për muze, por as për një tabelë të thjeshtë! Ish burgjet dhe kampet e internimit thuajse janë zhdukur nga faqja e dheut, herë nën babëzinë e mbivendosjes së projekteve industriale, herë me mbivendosjen e projekteve bujqësore. Ka arritur momenti i turpit të madh, sa ne të mos i identifikojmë më dot. Ajo që ka mbetur e vetmja gjurmë për të dëshmuar, janë skicat e kampeve, portretet dhe etydet e Lekë Pervizit.

Agron Tufa

Tiranë, 23 gusht 2014

Botim i Institutit të Studimit të Krimëve dhe Pasojave të Komunizmit, ISKK, Tiranë, 2014.

Me kontributin e Fondacionit gjerman Konrad Adenauer (Konrad Adenauer Stiftung).

Albumi u promovua në ish kampin e Tepelenës me 6 Nëntor 2014.

Ndërsa ky që paraqesim këtu është një album i krijuar nga vetë Lekë Pervizi

me paraqitje të të gjithë vizatimeve skicave që ka mundur të shpëtojë e ruaj gjatë


40 vjetëve që kaloi në ato kondita dënimi e që behën të njohura vetëm tashti pas

me rastin e botimit të vitit 2014, siç e përmendëm më lart.


Një falendërim i posaçëm i shkon drejtorit të Fondacionit Konrad Adenauer në Tiranë, z. Thomas Schrapel, i cili bëri të mundur botimin e Albumit dhe organizimin e mbledhjes përkujtimore në kampin e Tepelenës me 6 Nëntor 2014 ku atë aktivitet e nderoi me praninë e tij, A1mbasadori Gjermanisë, z. Helmut Hoffman.

Kampi i Tepelenës


1948-1954




Vizatim sipas originalit, të kampit të Tepelenës, siç ishte asokohë, me kazermat dhe ndertesa të tjera të ushtrisë italiane , i rrethuar me gardhe me tela me gjemba, për të penguar çdo tentativë ikje. Sipas kësaj skice është propozuar të behët nje maket për muzeun e krimeve te komunizmit, që të mbetët dokument, pasi kampi nuk ekziston më, veç fusha dhe kazermat e e rrënuara.




Skelet e krevetëve të ushtrisë italiane ku ishin stivosur t'interneuarit, kryesisht, pleq, gra e fëmijë.
Policët qarkullonin vazhdimisht ndër kazermat, ditë e natë., si lugetër.
Skicat janë marrë nga origjinali dhe jepën për herë të parë.



T'internuarit ishin te detyruar te rrinin ne vendet e tyre, poshtë familjet me pleq, gra e fëmijë, lart beqarët, kryesisht burra, të rreshtuar njeri pas tjetrit. Ata i nënështröhëshin punës të detyruar si kafshë bartës



Pamje e brendshme e përgjithshme e një gazërme me skelet dy katëshe të krevatëve.
Përmasat e kazermave ishin cikloprike : 40 x 16 m, e lartësi 6 m, pa llogarit çatinë




Pamje e sistemit të skeleve të ndërtuara nga ushtria italiane ku u vendosën t'intenuarit



Prerje e një gazerme për të treguar se si ishin vendosur të internuarit dhe si jetonin në kushte errësire.

PLAN SKICA E KAMPIT TE TEPELENES – 1948-1954

(realizuar nga Lek Pervizi)






Znj. Prena (Ana) Pervizi, e ama e piktorit, vizatim me laps plumbi, Tepelenë 1951.
I pari vizatim në atë kamp. Ajo pësoi 32 vjet internim, 1945-1977.



Valentin Pervizi, oficer akademist, vëllai i piktorit, Tepelenë 1951.
47 vjet burg-internim, 1944-1991.

Në këto skica tregohet në formë vargjesh rapsodike odhiseja e Valentinit nga Italia në Shqipërinë e burgjeve e kampëve.



Fat o fat pse tallësh me këtë njeri ?
N'luftë të rrebtë ti me ke pri, (Romë, shtator 1943)



M'dhe guxim me i hik gjermanit, (tetor 1943)



M'shpëtove prej mnerës s'aeroplanit (1943-1944)



M'çove në Vjenë në koh të frikshme (gusht 1944)



M'nise n' rrugë dhe ma t' rrezikshme (shtator-tetor 1944)




Në Atdhe m'premtove shpëtimin (tetor 1944)



Kurse m'njofte me burgimin, (Shkodër, dhjetor 1944)



Me internimin m'prezentove (Berat, 1946-1948)



Pak u tallë kur më lirove, (Tiranë, 1948-1950)



N'n kala-burg më izolo (Portopalermo, 1950)



Mandej m'çove me dimnue,
Nëpër shkrepë e mal të thatë



Fat i zi, fat i pabesë
Pse m'ke lanë kështu n'harresë ? ...1944-der 1991.


Shkrimet nuk kuptohen nga shkaku i letrës së keqe dhe nga vjetërsia , të shkruar para 64 vjetëve me laps plumbi, dhe të dëmtuara duke u transferuar vazhdimisht nga një vend në tjetrin. Kështu u munduem të bëjmë deshifrimin e shënimeve.



Vizatim me thengjill zjarri i vella Valentin, Tepelenë 1951.



Vizatim i kalasë së Tepelenës nga një dritare e kazermës Nr.1, Tepelenë 1951




Pesha 650 gramin e racionit , thika që priste bukën dhe lapsi që shënonte në listë.




Llesh Dod Gjini, ditën e lirimir më shtator 19 92 nisurn në kambë rrugës Kelçyrës për në Berat vdiq n'udhëtim nga vuejtjet e mumdimet.



I biri, Gjini Lleshi, vazhdoi te qendrojë ne internim deri 1964



Një malësor (?)



Një myzeqar (?).



Vajzat e gratë përdorëshin si kafshë pune në transportin e barrëve të druve e të tjera peshë të rënda, për dhjetra kilometra shtigje malore, nga mëngjesi deri në mbrëmjen vonë, të shoqëruara nga police t'armatosur e shpirt kriminelë. Vizatimi projekt për tablo.



Burrat vihëshin në transportin e trungjëve e shtyllash, të ruajtur rreptësisht nga police t'armatosur. Porjekt për tablo.



Masakra e fëmijëve. Projekt për tablo. Në një natë të vetme, në një kazermë të kampit të Turanit të Tepelenës, më Gusht 1948, vdiqën nga një epidemi kolerike 33 fëmijë e foshnje të njoma, përveç dhjetra të tjerëve gjatë asaj kohë, ku përfshihëshin edhe pleq e plaka. Tragjedi e papërshkrueshme.



Vajzat e internuara të Tepelenë sa mbushinn 15 vjeç, i nënshtrohëshi punës së rëndë të detyrueshme.


Ato u rritën e u mplakën në kampet e internimit. Askush nuk e qan fatin e tyre

As nuk ua njohin të drejtat legjitime që u takojnë për denimet e pësuar.

Kuç i
Kurweleshit
1954-1958




Akuarel nga origjinali. Kampi i Kuçit në dy shtëpi të familjës Gjoleka të riparuar nga të burgosurit. Këtu rrinin të dënuar 100 burra me tri herë në ditë apel. U jepej bukë për një javë.




Bashkëvuejtës : Valentin Pervizi, Viktor Dosti, Guljelm Deda e Thabit Rusi.
Vizatm në karton të vjetër amballazhi, me thëngjill zjarri.




Shokë burgjësh e kampësh,
 Ded Gjomarkaj, student, Thabit Rusi, student,
 Prof.Dr. Mitat Araniti, Jurist, shkrimtar, poliglotr.



Prof. Dr. Mitat Araniti, Pjesmarrës në mbledhjen e Mukjës.



Prof. Dr. Mitat Araniti,
Shkrimtar, poliglot, perkthyes




Dr. Nedim Kokona, vëlla i Vedadi Kokonës,
Sekretar i pergjithshëm i Kryeministrisë.




Prof. Dr. Ali Cunge, (Shkollë e Fulcit).
Profesor matematike, poliglot.



Ylber Starova, student, e Prof. Ali Cunga duke luajtur domino




Inxh. Estref Frasher, Dr. Latif Spahiu.




Dr. Sandër Saraçi, funksioinar i lartë shteti.



Dr. Loro Muzhani, funksioinar i lartë shteti.




Prof. Dr. Ali Erebara, kolonel, avokat, poliglot.



Valentin Pervizi, officer akademist.



Prof. Dr. Guljelm Deda, Profesor letërsie e gjuhë të vjetra, poet.
Përkthyes i poemit të Ludoviko Ariostos "Orlandi i çmendun", që u botue më 2013



Oxhaku i dhomës së të rinjve, ku bëheshin debate të forta.




Pjetër Bardheci nga Puka.




Viktor Hasan Dosti, student




Viktor Dosti dhe dora e koka e Ibrahim Sokolit





Tomorr Fiqri Dine, duke mesuar anglishtën. Kuçi u kthye ne një shkollë e universitet për të rinjtë, ku 60 të burgosur ishin me tituj e diploma të larta.



Tomorr Fiqri Dine, student




Dr. Ibrahim Sokoli, nën jorgan.




Vizatimi dhe realizimi i skulpturës në rrëjë shqope (kuckë) - Luftim me Përbindëshin
Kësaj skulpture Prof. Guljelm Deda i kishte kushtue një poezi.

Kampi i Plukut
Lushnjë
1958-1990


Me motive familjare




Autoportret me
thëngjill, Pluk 1960



Vëllai Genc, kampi I Graçdishtës, 1962



Vëllaj Genc, kampi i Gradishtës,, 1967.




Ernest Dosti, e Rëshit Mulleti, laps , Savër, 1964.



Vajzë kampi, laps, Savër, 1964



Portret i gruas, Beba, Pluk, 1966.



Nipi David, e gruaja ime Beba, laps, Pluk , 1968.



Mbesat, Eva dhe Edi, Pluk, 1970



Gruaja ime Beba duke punuar triko, laps, Pluk, 1974.



Portret I djalit të vogëm, Aurel, laps, Pluk 1976



Portret i djalit të vogël, Aurel, për të realizuar një gravurë në xham



Skicë, mama, një grue komshije dhe mama duke pushue.

Kampi Pluk


1960-1982




Prena (Ana) Pervizi, vaj mbi beze, 1962




Gjulina Pervizi (Beba), vaj mbi fibër kartoni, 1974



Autopotret, vaj mbi karton, 1962



Portret i vällait Valentin, vaj mbi karton, 1962



Portret i djalit Leonard, vaj mbi beze, 1974.



Portreti I djalit dytë, Dorian, vaj mbi beze, 1974.



Kodra e Gradishtës, val në karton libri, 1960, 19x 14 cm.



Gradishtë, kisha e Shëna Premtës, afër kampit, vaj mbi karton, 1960, 13 x 8 cm.



Kampi i Kuçit, vaj mbi karton libri, 1960, 13,5 x 8,5 cm.



Skënderbeu, vaj mbi beze, Pluk, 1982, 100 x 80 cm
Ruhet pranë familjës Mullaj, Konispol.



Betejë e Fushë Kuqës, (Fushë Milot), 2 shtator 1457, fituar nga Shqiptarët me Gjergj Kastriotin në Krye, vaj mbi beze, Pluk, 1968-1980, 2,80 x 1,60 m.



Natyre e qetë me lule fushe, vaj, mbi karton Pluk, 1962,



Natyrë e qete, viti ri 1974, Pluk, vaj mbi beze, 40 x 40 cm



Vaj në kompensato, Pluk, 1964
Dhurrar një miku të huaj.




Autortret
Gravure në xham, Pluk, 1982. Specialitet imi.



Autoportret, tush, Pluk, 1974



Auportret, laps, Pluk, 1980



Autoportret, tush, Pluk, 1981

*Nga libri me poezi
Ankimi i Zanave*



Tinguj të kombshëm (autoportret)



Porto Palermo



Holokausti fëmijëve (kala e mallkueme)




Mater Dolorosa



Maskrat



Pesha e qizmës



Monumenti shek. XX



Balada e bukës



Pas kafazit të hekurt të burgut.
Gravure në letër.

